



Pranuar / Dorezuar Primitjen / Primitje Received / Delivery	02 - 11	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	6824 / 2023		1 / 6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1141/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Ardita Percuku Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1141/2023, të datës 05.09.2023, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ nga Fushë Kosova, kundër Vendimit me numër të protokollit 69/2023, të datës 18.08.2023, të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1; nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.11.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1141/2023, e datës 05.09.2023, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ **Anullohet** Vendimi me numër të protokollit 69/2023, i datës 18.08.2023, i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.
- II. Obligohet** Kryesuesi i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshëm ligjore-administrative për zbatimin e këtij vendimit, sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ (tutje vetëm ankuesi), më datë 05.09.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1141/2023, kundër Vendimit me numër të protokollit 69/2023 të datës 18.08.2023, të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore “vërejtje me shkrim”, me pretendimin së vërejtja nuk benë pjesë në shkeljet e lehta sipas nenit 96.1 të Rregullores së Prokurimit Publik,



vlerësimi dhe shqyrtimi i tenderëve është përgjegjësi e Komisionit Vlerësues dhe së kontrolli i faturave teknikisht është i pamundur për shkak të numrit shumë të madh. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj Bordin e KRPP-së që të largoj nga vendimi i datës 18.08.2023 me numër 59/2023, pjesën ku ceket shqiptimi i masës disiplinore “vërejtje me shkrim”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.09.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, ndërsa, kjo e fundit, më datë 21.09.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 6595/2023, të datës 18.10.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1141/2023, të datës 25.08.2023.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 5951 të datës 05.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Fatura me numër 413-210-001.21 të datës 29.12.2023; emaili i datës 16.01.2023 i ankuesit për ATK-në lidhur me verifikimin e faturës me numër 413-210-001.21 të datës 29.12.2023, emali i datës 26.01.2023 nga zyrtari i ATK-së për ankuesin lidhur me verifikimin e faturës me numër 413-210-001.21 të datës 29.12.2023, vendimin me numër të protokollit 69/2023 të datës 18.08.2023 të Kryesuesit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, Njoftimin më numër te protokollit 71/2023 të datës 21.08.2023 te Kryesuesit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, lidhur me korrigjimin e Vendimit me numër te protokollit 69/2023 të datës 18.08.2023; kërkesën për përgjigje në ankesë të Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, përgjigjen në ankesë më numër të protokollit 1141/2023 të datës 21.09.2023 kërkesën datës 20.06.2023 të OSHP-së drejtuar, Kryesuesit të KRPP-së, për anulim të certifikatës së prokurimit për ankuesin, shkresë e Komisionit për shqyrtimin e e shkresës së OSHP-së të datës 20.06.2023; sqarim nga ankuesi i datës 07.08.2023 tek Komisioni shqyrtues, email i datës 13.07.2023 nga A. Rexhepi për ankuesin, email i datës 17.07.2023 nga ankuesi për A. Rexhepi, kërkesën nga portali Indeksonline i datës 16.01.2023, Vendimi me numër protokollit 382/2023 të datës 7.10.2023 të OSHP-së; Vendimi P.sh.Nr.109/23 dhe Nr.115/23, dhe me numër te protokollit 109,115/23 të datës 31.05.2023 e-mail nga Kryesuesi i KRPP-së për A. Rexhepi, vendimin Vendimin me numër protokollit 6595/2023, të datës 18.10.2023 të Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Akt Emërimin-Plotësim dhe Ndryshim i datës 04.04.2019; dhe Vendimin me numër AQO22/23 të datës 01.09.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se ankuesi ka qenë i punësuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, në pozitën e punës Udhëheqës i Sektorit për Prokurori të Specializuar, tani i dorëhequr nga kjo pozitë.

Me tej, nga provat materiale të kësaj çështje, rezulton se Kryetarja e Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit ( tutje referuar OSHP-ja), me datë 20.06.2023 ka parashtruar kërkesë të Kryesuesi i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (tutje KRPP-ja), për anulimin e certifikatës së



prokurimit ndaj ankuesit në pozitën e menaxherit të zyrës së prokurimit, me arsyetimin se i njëjti nuk ka respektuar legjislacionin e prokurimit publik për aktivitetin e prokurimit me numër të prokurimit UA/2016-22-3427-1-1-1.

Bordi i KRPP-së pas kërkesës së OSHP-së të datës 20.06.2023, me Vendimin Nr.42/2023 të datës 03.07.2023 ka caktuar Komisionin për shqyrtimin e kërkesës së OSHP-së, ndërsa, ky i fundit, më shkresën e datës 20.07.2023 ka konstatuar se edhe pse është përgjegjësi e Komisionit Vlerësues, vlerësimi i tenderëve, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit para dhe pas aprovimit të raportit të vlerësimit ai dhe gjatë vlerësimit të tenderëve duhet të këshilloj Komisionin që të verifikoj të gjitha dokumentet me qëllim që ti shmang me kohë situatave të faturave fiktive, duke i rekomanduar Bordit të KRPP-së që ndaj ankuesit të shqiptohet masa sipas nenit 98 të Rregullores për Prokurim Publik për shkelje të lehta.

Bordi i KRPP-së më vendimin me numër të protokollit 69/2023 të datës 18.08.2023, ka refuzuar kërkesën e OSHP-së për anulimin e certifikatës profesionale për ankuesin si zyrtar përgjegjës i prokurimit publik të Autoritetit Kontraktues-Agjencisë Qendrore të Prokurimit, ndërsa, ndaj ankuesit ka shqiptuar masën “ vërejtje me shkrim”.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i'u referua nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje LPPA*) më të cilin përcaktohet se: *Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës konstaton së ankesa A.nr.1141/2023 është e pranueshme, mbi bazën se ankuesi ka legjitimitetin e palës për të ushtruar ankesë, ankesa është ushtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1, të LPPA-së, dhe si rrjedhojë Këshilli ka juridiksion për trajtimin e kësaj çështje juridiko-administrative, ashtu siç përcaktohet me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërlidhur me paragrafin 2 i cili parashihet: "2. Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.....", dhe Ligjin Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku parashihet:"1.1.Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil“.*

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe si rrjedhojë ka konstatuar së i njëjti është nxjerr mbi bazën e nenit 25 paragrafi 8 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092) si dhe nenin 98 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 25 paragrafi 8 të ligjit bazik për prokurim publik gjegjësisht Ligjit Nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 11 të Ligjit Nr. 05/L-068, me të cilin është përcaktuar se: *Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga KRPP-ja ose IKAP-i mund të anulohet nga KRPP-ja nëse konstatohet se personi i cili e posedon atë certifikatë nuk i plotëson ose më nuk i plotëson kushtet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji ose ka bërë një shkelje të rëndë të këtij ligji ose të rregullave të prokurimit. Nëse poseduesi i certifikatës është nëpunës civil, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Shërbimin Civil. Nëse poseduesi i certifikatës nuk është nëpunës civil, KRPP-ja*



duhet ti dërgojë këtij personi një njoftim paraprak me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj; ky njoftim i jep personit në fjalë të drejtën e ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative, personi në fjalë është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative. Pas periudhës një vjeçare zyrtari në fjalë mund të filloj trajnimin bazik. 9. Në bazë të një kërkesë nga një autoritet kontraktues ose OSHP, KRPP-ja vendos nëse janë plotësuar kushtet e kualifikimit të specifikuara në nenin 23 apo janë bërë shkelje të rënda të këtij ligji ose rregullave të prokurimit për një certifikatë profesionale të prokurimit. Në rast se KRPP-ja konstaton se kushtet e përmendura janë plotësuar, KRPP-ja do të vazhdoj me procedurat e theksuara në paragrafin 8 të këtij neni.

Në këtë aspekt, dhe duke u nisur nga fakti së ankuesi ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji konstaton së marrëdhënia e punës së nëpunësve civil është e rregulluar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i aplikueshëm nga data 09.07.2020 deri me 26.09.2023, dhe së i njëjti me dispozitat e nenit 85, ka shfuqizuar Ligji për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligji. Rrjedhimisht, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik krijimi, ndryshimi si dhe përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, rregullohet vetëm sipas këtij ligji, e mbi këtë bazë rezulton se lidhur me procedurën disiplinore gjegjësisht lidhur me iniciimin e procedurës ndaj nëpunësve civilë, vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore dhe masave disiplinore, aplikohen vetëm dispozitat e kapitullit IV të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Në lidhje me konstatimin si me sipër, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkitazi me disiplinën në shërbimin civil, me theks të veçantë :

- **Nenit 45:** Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.
- **Nenit 46** Shkeljet disiplinore 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit





- civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.
- **Neni 47:** Masat disiplinore 1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil.
  - **Neni 48:** Kompetenca dhe procedura disiplinore 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor. 4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtarit të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore....
  - **Neni 49:** Krijimi dhe përbërja e komisionit disiplinor 1. Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse.
  - **Neni 50:** Parimet e individualizimit të masave disiplinore 1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore.

Andaj, në kontekst të kuadrit ligjor si me lart, Kolegji konstaton së shqiptimi i masës disiplinore ndaj ankuesit nga Bordi i KRPP-së përmes vendimit me numër të protokollit 69/2023 të datës 18.08.2023, është në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 8 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, sepse, konstatimi i shkeljeve të ligjit për prokurimin publik si shkelje disiplinore, mund të behët vetëm nga organi kompetent sipas nenit 48 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Zyrtaret Publik. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit, OSHP-ja dhe KRPP-ja në rast se gjatë ushtrimit të autorizimeve të tyre ligjore, pretendojnë se zyrtari i caktuar i prokurimit ka bërë shkelje të legjislacionit të prokurimit, mund të iniciojnë procedurë disiplinore ndaj zyrtarit në fjalë tek organi kompetent në pajtim me legjislacionin për zyrtaret publik apo që paraprakisht të themelojnë (e drejtë kjo që buron nga ligji bazik për prokurimin publik) komisione ad hoc për hetim të shkeljes së legjislacionit të prokurimit publik, dhe mbi bazën e të gjeturave të komisioneve mund të iniciojnë procedurë disiplinore kundër zyrtarit të prokurimit në pajtim e legjislacionin e shërbimit civil.

Theksuar si me lartë, e në kuptim të dispozitave të nenit 53 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një vendim i nxjerrë nga organi publik që nuk ka kompetencë lëndore është vendim i paligjshëm dhe si i tillë nuk prodhon pasoja juridike, kështu që mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kolegji i Këshillit rikujton faktin se vendimi i kundërshtuara me ankesë anulohet vetëm për shkak të jo kompetencës, ndërsa, organet gjegjëses pas këtij vendimi mund të ndërmarrin veprime në pajtim me udhëzimet juridike të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1141/2023

Ardita Percuku Shyti

*Ardita Percuku Shyti*  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

*Ardita Haxhnikaj Demi*  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërrshohet:

- Ankuesit .
- Kryesuesit të KRPP-së;
- Kryesuesit të OSHP-së;
- Kryesuesit të AQP-së
- Arkivit të KPSHCK-së